



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.124

31 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.522, datë 20.7.2011

Për “Miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor
afatmesëm 2012 –2014”..... 4883

VENDIM
Nr.522, datë 20.7.2011

**PËR “MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2012 –2014”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2012-2014, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesem (PBA)

1. Programi Buxhetor Afatmesem është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: Rishikimit të Politikave dhe Planifikimit të Shpenzimeve. Planet e shpenzimeve hartohen nga ministrat e linjës brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjere lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor.

2. Qellimet kryesore të PBA janë:

- *Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;*
- *Lidhje e drejtperdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;*
- *Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;*
- *Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3 vjeçare).*

Dokumenti i PBA hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuader të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale publike.

Gjithashtu, ai i shërben njesive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar gjithashtu që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përfundimin e:

- *Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;*
- *Produkteve të matshme;*
- *Aktivitetet të kostueshme.*

A.2 Programit Buxhetor Afatmesem dhe Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, me nje horizont planifikimi prej 7 vitesh, percakton strategjite dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata per te gjithë sektoret, bazuar ne nje vizion kombetar. Per arrijten e nje prej synimeve kryesore te SKZHI-se, antaresimin e Shqiperise ne NATO, nje rol te rendesishem luajti edhe Programimi Buxhetor Afatmesem. Ky program do ti sherbeje edhe arrijtes se aspiratave te SKZHI-se per Integrimin Europian.

Per procesin e Programit Buxhetor Afatmesem 2012-2014, elementi strategjik i PBA-se u sigurua nepermjet konsultimit te strategjiave sektorale dhe ndersektorale pergjate procesit te Rishikimit te Politikave se Programit – percaktimi i qellimeve dhe objektivave per cdo program shpenzimesh te cdo ministrie. Ky proces u ndermorr nga nje bashkepunim i ngushte ndermjet Ministrise se Financave, Ministrise se Integritimit dhe Departamentit te Bashkerendimit te Strategjiave dhe Koordinimit te Ndhimes se Huaj, ne Kryeministri.

A.3 Procesi i Pergatitjes se PBA-se 2012 – 2014

Tabela 1, paraqet ne menyre te permblendhur hapat kryesore ne procesin e pergatitjes se PBA-se 2012-2014, te ndermarre ne perputhje me kalendarin e Sistemit te Planifikimit te Integruar te miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

Tabela 1 Fazat e Pergatitjes se PBA-se		
FAZAT	KOHA	PERSHKRIMI
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe pergatitja e tavanave te PBA-se per secilen ministri	Tremujori I	• Pergatitja e tavanave te pergjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomike permes parashikimit makroekonomik. • Identifikimi i prioriteteve te politikave dhe zerave me ndikim te rendesishem ne shpenzime e te ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesore te investimeve publike) • Vendosja e tavanave per gatitore te PBA-se • Pergatitja e Udhezimit per Pergatitjen e Buxhetit.
Qeveria miraton parashikimin makro, tavanet e pergjithshme dhe tavanet per gatitore te PBA-se 3-vjecare per cdo ministri		
2. Rishikimi i Politikave se Programit (RPP).	Tremujori II	• Ministrit vendosin politikat per cdo program dhe identifikojne qellimet dhe objektivat e programit.
3. Plani i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP).	Tremujori II	• Brenda tavanave te percaktuara, ministrit zhvillojne PSHIP duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet ne baze te fondeve ne dispozicion per cdo program. • Dorezimet e PBA-se jane plotesisht te reflektuara ne Planin e Integruar te Ministrise.
Qeveria miraton projekt dokumentin e PBA		
4. Pergatitja e Buxhetit	Tremujori III	• Pergatitja e Udhezimit Plotesues per Pergatitjen e Buxhetit. • Ministrit paraqesin buxhetet e detajuara.
Qeveria miraton projektin e PBA te rishikuar dhe projektligjin e buxhetit dhe i dergon ne Kuvend perkatesisht per informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi ne Kuvend	Tremujori IV	• Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor te buxhetit nga Kuvendi.

Shenim: Dokumenti perfundimtar i PBA publikohet ne fillim te vitit pasardhes pas miratimit te ligjit vjetor te buxhetit nga Kuvendi.

A.3.1 Rishikimi i Politikave se Programit (RPP)

Nevoja kryesore per nje manaxhim efektiv te financave publike eshte percaktimi i qarte i politikave. Per politikat e reja kjo mund te arrihet nepermjet zbatimit te nje procesi te mire te percaktimit te politikave, domethene nepermjet permiresimit te hartimit te politikave.

Ne praktike, procesi i hartimit te politikave nuk ka qene gjithmone i frytshem persa i perket qartesise se politikave. Procesi i PBA-se merr nje rendesi paresore ne perpjekjet e qeverise per te lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Per te arritur kete, politikat duhet te jene te qarta, te kuptueshme dhe te rishikohen rregullisht nepermjet nje procesi te rishikimit te politikave se programit i cili eshte i integruar me procesin e planifikimit te shpenzimeve dhe investimeve, percaktimit te kostove dhe pergatitjes se buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit (PSHIP)

Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve te Programit eshte pjese e planifikimit strategjik dhe

pason Rishikimin e Politikës së Programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA-së. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet gjithashtu në kontekstin e prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës të përcaktuara për çdo sektor, domethënë, nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit. PSHIP reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i PSHIP të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë, është vendosja e tavanëve të shpenzimeve, që përben kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qëllim të caktuar. PSHIP ndërmerret nga ministrat e linjës duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës për Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që u përfshijnë për herë të tretë në këtë proces dhe që nuk kanë akses në sistemin e informatizuar, planifikimi i shpenzimeve u mundësoi nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së buxhetit.

A.3.3 Kërkesat për Shpenzime të PBA

Pas përfundimit të fazës së PSHIP, njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre paraqesin kërkesat përkatëse për shpenzime të PBA. Këto kërkesa duhet të jenë rigorozisht brenda tavanëve të përcaktuara nga Komiteti i Planifikimit Strategjik pranë Këshillit të Ministrave, si dhe të jenë të miratuara nga titullaret respektive.

A.3.4 Kërkesat Shtese për Shpenzime të PBA

Kërkesat shtese për shpenzime të PBA paraqesin nevojat për financim të programeve përkatëse të njësive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre, të cilat nuk mund të mbulohen brenda tavanëve të përcaktuara nga Ministria e Financave. Këto kërkesa përfshijnë gjithashtu një shpjegim se pse njësia e qeverisjes qendrore përkatëse nuk mund të sigurojë një kursim eficient nga Programet e tjera.

Miratimi i Kërkesave Shtese të PBA, për një ose më shumë njësi të qeverisjes qendrore, kërkon rialokimin e burimeve nga programet me pak prioritet të njësive të tjera të qeverisjes qendrore, e cila vendoset nga Këshilli i Ministrave.

A.3.5 Miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014

Pas analizës dhe shqyrtimit të kërkesave për shpenzime të PBA dhe kërkesave shtese të PBA, Ministria e Financave përgatit materialin e përmbledhur në Projekt Dokumentin e PBA i cili paraqitet për shqyrtim pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe më pas për miratim përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

A.3.6 Roli i Ministrisë së Financave

Roli i Ministrisë së Financave është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Nuk është roli i saj primar për të analizuar objektivat dhe qëllimet e politikave të sektorit; kjo është përgjegjësia e Këshillit të Ministrave. Roli i saj kryesor është që, gjatë fazës së Rishikimit të Politikës së Programit, të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet mbështetëse dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para që do të thote në mënyrë ekonomike, efektive dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave në fazën e Planifikimit të Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është i dyfishtë.

- i) *Detyra e saj e parë* është: t'i bëjë propozime Këshillit të Ministrave për Tavanet e Përgjithshme të Shpenzimeve dhe Tavanet Përgatitore të PBA-së.
- ii) *Ndërsa detyra e saj e dytë* ka të bëjë me vlerësimin e faktit nëse ministrat po arrijnë eficienten, efektivitetin dhe ekonomi në zbatimin e programeve, gjë të cilën ajo e mban parasysh kur bën propozim e Tavanëve Përgatitore të PBA-së.

A.3.7 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimarrës, pasi të

gjitha propozimet e rendesishme qe kane te bejne me Sistemin e Planifikimit te Integruar ne pergjithesi, dhe Programit Buxhetor Afatmesem ne vecanti, kalojne detyrimisht per shqyrtim prane ketij Komiteti perpara se te marrin miratimin perfundimtar prane Keshillit te Ministrave.

Ne procesin e pergatitjes se PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Keshilli i Ministrave luajne nje rol paresor ne drejtim te miratimit te nje sere etapash te rendesishme te tilla si:

- *Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal per periudhen e PBA*
- *Tavanet Pergatitore dhe Perfundimtare te PBA*
- *Kalendari i SPI*
- *Projekt Dokumentin e PBA*
- *Dokumentin e PBA te rishikuar*

B. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal per Periudhen 2012-2014

Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal per periudhen 2012-2014 eshte pjese e Sistemit te Planifikimit te Integruar dhe pergatitet nga Ministria e Financave. Kuadri makroekonomik e fiskal pergatitet me qellim qe te ofrohet informacion per percaktimin e perpareseve strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve ne lidhje me te ardhurat dhe deficitin, si edhe per percaktimin e taveve per te filluar procesin e pergatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) ne nivel ministrie. Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik ne muajin e pare te cdo viti, dhe eshte subjekt rishikimi dhe perditesimi ne dy momente kyç gjate vitit; ne muajin Maj, perpara finalizimit te PBA-se dhe te taveve te PBA-se per shpenzimet, dhe ne muajin Shtator, perpara dergimit ne Parlament te projekt buxhetit te shtetit.


Kuadri makroekonomik e fiskal per periudhen 2012-2014 perbehet nga dy pjese kryesore. Ne pjesen e pare paraqiten vleresimet mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale gjate vitit 2010 dhe tremujorit te pare te vitit 2011, dhe pjesa e dyte trajton parashikimet e treguesve kryesore makroekonomik, parashikimin e burimeve ne dispozicion te qeverise dhe shperndarjen e tyre per periudhen 2012-2014.

B.1 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Gjate dekades se fundit ekonomia shqiptare ka njohur nje progres te qendrueshem. Proceset e transformimit ekonomik dhe ristrukturimit dhe politikat makroekonomike te ndjekura ne 10 vitet e fundit ka rezultuar ne nje nga ritmet e rritjes me te larte ne rajon. Me nje rritje mesatare vjetore prej rreth 6 perqind, PBB-ja per fryme ishte me shume se trefishuar ne kete periudhe. Politikave fiskale dhe administrative te lehtesuara, kane ndihmuar biznesin per t'u bere me produktive. Zhvillimet pozitive ne sektorin e biznesit, vecanerisht ne ate industriale dhe ne ate te orientuar drejt sherbimeve, çoi ne nje rritje te punesimit dhe te te ardhurave familjare. Te ardhurat, ne nje pjese te financuara nga remitancat dhe nga zgjerimi i kredise tregtare, ka kontribuar per nje kerkese te forte te brendshme, e cila ka sjelle nxitjen e investimeve kapitale gjithnje dhe me te larta, si dhe te zgjerimit te prodhimit.

Gjate viteve te fundit, stabiliteti makro-ekonomik ne vend ka ndjere presionet e krizes nderkombetare financiare. Norma e rritjes per vitin 2009 eshte llogaritur ne 3.3 %, nje nga normat e pakta pozitive te regjistruara ne Evrope. Kjo u arrit nga ecuria pozitive e Bujqesise dhe e sektorit te Sherbimeve, si dhe nga ndjekja e nje politike ekspansioniste fiskale, e cila eshte reflektuar kryesisht ne pershpjellimin e investimeve publike qe arriti ne nivelin 9,9 % te PBB-se, duke kompensuar keshtu renien ne sektorin e industrise-nxjerrese dhe ne sektorin e Nderimit. Ne vitin 2010, politika fiskale ishte vendosur perseri ne nje rruge te qendrueshme dhe te deficitit publik u reduktua ne 3 % te PBB-se nga 7.1 %, qe ishte ne vitin 2009. Forcimi i shpejte i Eksporteve ishte kontribuesi kryesor ne ruajtjen e ritmeve te rritjes, vleresuar per tremujorin e III-te ne rreth 3,6 %, nderkohe qe investimet dhe sidomos konsumi kane patur nje rritje te ngadalte. Gjate kesaj periudhe papunesia pa vetem nje renie te moderuar dhe eshte aktualisht e qendrueshme ne 13,5 %. Inflacioni eshte nen kontroll brenda intervalit objektiv te bankes qendrore prej 2 - 4 %. Ne tetor 2010, Shqiperi arriti te bej shfaqjen e pare te saj te eurobondit 5 - vjeçar prej 300 milione ne tregun nderkombetar me nje afat maturimi prej pese vjetesh, me nje norme interesi maksimal 7,5 %.

Sektori real



Brenda një konteksti me pasiguri të larta ekonomike botërore në 2010, Shqipëria ka vazhduar të përjetojë ecuri të kenaqshme ekonomike. Sipas të dhënave paraprake nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT),

PBB-ja reale u rrit me 5.4 % në tremujorin IV-të 2010, duke përsheptuar ritmin e saj nga 5.0 % në T-3, 3.0 %

ne T-2, dhe 2.2 % ne T-1 të vitit 2010 dhe nga një performancë negative prej -0.6 % ne T-4 të vitit 2009. Përsheptimi në rritjen vjetore të PBB-së reale është mbështetur nga reagimi i industrisë, ku vlera e shtuar bruto u rrit me 18.7 % ne T-1 të 2010, 21.1 % ne T-2, 17.1 % ne T-3 dhe 22.2 % ne T-4 të po këtij viti (nga 2.1 % që ishte në vitin 2009).

Analiza strukturore e aktivitetit industrial tregon kërkesë me të fortë për industrinë nxjerrëse (deri me rreth 65 %), po ashtu edhe për energjinë elektrike, gazin dhe aktivitetin e ujit (deri me 34 %). Edhe pse dinamika e rritjes së ritmit vjetor të parë në këto sektorë përfshin një efekt thelbësor, si ndikues baze do të merren parasysh kontributet pozitive të rimekembjes së partnerëve kryesorë tregtarë të ekonomisë Shqiptare, si: çmimet me të larta të mallrave industriale në tregun ndërkombëtar dhe zhvlerësi relativ i monedhës vendase siç është ilustruar nga eksportet e larta të produkteve industriale. Zhvillimet e ekonomisë reale gjatë vitit 2010 janë mbështetur edhe nga indekse të tjera afat-shkurtra (3 - mujore), të tilla si Indeksi i afarizmit, Numri i punonjësve dhe nga Indeksi Fondit Total të Pagave.

Ndonëse nuk janë ende të disponueshme të dhënat statistikore të llogarisë kombëtare sipas metodës së shpenzimeve, në bazë të treguesve të tjerë indirekt të disponueshëm, duket se kërkesa e brendshme, si për konsumin ashtu dhe për investimet, ka pësuar një rritje disi të ngadaltë gjatë gjithë 2010. Vihet re se, që nga tremujori i katërt i vitit 2010 dhe më qartë gjatë katër muajve të parë të 2011, importet e të mirave kapitale (makinerive) janë rritur në mënyrë të qëndrueshme. Rritja në importet e makinerive, rritja e dukshme e kredisë për sektorin privat për qëllime investimi, si dhe rritja e investimeve publike në krahasim me 2010, në mënyrë të qartë tregojnë për një rigjenerim të investimeve në 2011.

Duke ju referuar anës së ofertës, sektorët që patën performancë të lartë në vitin 2010 ishin "industria", "transporti", "tregtia dhe hotelet" dhe "bujqësia". Vlera e shtuar e këtyre sektorëve është rritur përkatësisht me 20.4% për sektorin e industrisë, 9.8% për sektorët e "tregtisë dhe hotelet" dhe "transportit", si dhe me 6.6% për sektorin e "bujqësisë". Sektori i "shërbimeve të tjera" u rrit me 5.9%, ndërsa sektori i "ndërtimit" përjetoj një tkurrje prej 21.3% e ndjekur nga rritja negative në sektorin e "postë – telekomunikacionit" me 7.3%. Gjatë vitit 2011, pritet që sektorët e "industrisë", "shërbimeve" dhe "bujqësisë" të vazhdojnë të ketë një rritje pozitive (edhe pse më të moderuar për sektorin e "industrisë"), ndërsa sektori i "ndërtimit" të rikthehet në rritje pozitive.

Gjatë vitit 2010 eksportet u rritën me 56.4% krahasuar me vitin 2009 ku grupi "Minerale, lende djegëse dhe energji elektrike" ishin grupi me kontributin me të lartë në rritjen totale të eksporteve me rreth 23.6 pike përqindje. Kjo rritje shpjegohet nga kërkesa e lartë për mineralet vendase, ku Kina po bëhet dhe importuesi më i madh i mineraleve shqiptare; gjithashtu shpjegohet edhe nga fakti i rritjes së prodhimit të energjisë elektrike.

Eksportet e mallrave kanë vazhduar të ndjekin trendin e lartë të rritjes ekonomike edhe gjatë dy muajve të parë të 2011 me një rritje prej 54% në Janar dhe 77% në Shkurt 2011. Ndërsa importet u rritën me rreth 17% dhe si pasojë bilanci tregtar gjatë periudhës Janar - Shkurt 2011 është përmirësuar me 7.6% në terma vjetorë. Ndërsa në muajt Mars dhe Prill, situata për sa i përket tregtisë së jashtme ka ndryshuar disi, me një ngadalësim të rritjes së eksporteve në rreth 15% dhe importeve në po të njëjtën rritje prej rreth 17%, duke rezultuar në një zgjerim të deficitit tregtar. Bilanci tregtar u përqësua me rreth 5.6% në terma vjetorë për katër muajt e parë të 2011.

Bilanci i pagesave rezultoi me një tepëriç të konsiderueshme prej rreth 179 milion euro, duke u rritur me këtë mënyrë rezervat valutore në nivelin e 1.9 miliard euro, të mjaftueshme për të financuar

rreth 4.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. Teprica në bilancin e pagesave erdhi si pasojë e përmirësimit të bilancit të llogarisë korrente me 21.5% ose me rreth 290 milion Euro më shumë krahasuar me vitin 2009, ndërsa teprica e llogarisë financiare dhe kapitale ishte rreth 120 milion euro më pak se në vitin 2009. Përmirësimi i bilancit tregtar ishte kontribuesi kryesor i reduktimit me 21.5% të deficitit të llogarisë rrjedhëse, ose me 3.6 pp të PBB-së (nga 15.5% e PBB në 2009 në 11.9% në vitin 2010). Rritja e tepricës në bilancin e shërbimeve me 50.2% ishte gjithashtu një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e llogarisë korrente. Në të njëjtën kohë remitancat u ulën me 11.7% krahasuar me 2009 (rreth 90 milion euro më pak) ose 7.8% të PBB-së nga 9% të PBB-së që ishin në vitin 2009. Flukset neto të IHD-ve u rritën me 23% gjatë vitit 2010. Në kontrast me vitin 2009, ku rreth gjysma e IHD-ve ishin në formën e privatizimeve të kompanive shtetërore ekzistuese, në vitin 2010 pothuajse të gjitha investimet e huaja ishin të llojit “green field”. IHD në vitin 2010 ishin në gjendje të financonin rreth 80% të deficitit të llogarisë korrente, më shumë se mesatarja prej 50% që ka qenë në dhjetë vitet e fundit.

Perkunder besimit të përmirësuar në të ardhmen e afert, preferenca e familjeve për ruajtje është rritur, siç ka dëshmuar dhe bilanci në rritje të kursimeve në treguesin e besimit të konsumatorit dhe rritjen e depozitave me afat.

Kushtet e tregut të punës janë përmirësuar disi në tremujoret e fundit të 2010, pas ngrerit në T-1 të po këtij viti, duke pasqyruar rimekembjen në aktivitetin ekonomik. Punesimi në sektorin Privat jo-bujqësor u rrit me 1,8 % në terma vjetorë në T-2 të 2010 dhe vazhdoi të rritet me 2.6 % dhe 3.1 % në T-3 dhe T-4 të po këtij viti. Përmirësimi i punesimit në sektorin Privat jo-bujqësor ka reflektuar kryesisht rritje të numrit të punësuarve në Industri dhe në sektoret e Shërbimeve. Këta janë sektoret me performancën më të mirë në aspektin e vlerës së shtuar në rritje. Në të kundërt, të punësuarit në sektorin e ndërtimit pësori një rënie.

Totali i punesimit në sektorin Privat (me përjashtim të sektorit Bujqësor) është rritur nga 1.375 persona gjatë T-1 të 2010, në krahasim me 3 - mujorin paraardhës, e ndjekur nga një rritje shtese të 4380, 657 dhe 1538 persona respektivisht në T-2, T-3 dhe T-4 të po këtij viti. Në sektorin Publik, punesimi ka mbetur pothuajse i pandryshuar nga 3 - mujori në 3 - mujor. Në sektorin e Bujqësisë, punesimi ka mbetur konstant gjatë gjysmës së parë të 2010 dhe është rritur në mënyrë të konsiderueshme me 10.474 persona në T-3 2010 duke ngjatur i pandryshuar edhe gjatë T-4 të vitit.. Numri i personave të papunë ka mbetur pothuajse i pandryshuar në T-2 të vitit 2010, në krahasim me 3 - mujorin e mëparshëm dhe pësoi rënie me 1.423 gjatë T-3 dhe më tej me 178 persona gjatë T-4 të vitit 2010. Shkalla e papunësisë në të vërtetë qëndron në 13.5 % duke shënuar një rënie të moderuar nga 13.8 % në vitin 2009. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, shkalla e papunësisë ishte 13.43 % duke shënuar një rënie prej 0.4% krahasuar me tremujorin I të vitit 2010.

Sektori monetar

Gjatë 2010, inflacioni mbeti mbi objektivin e 3%, por brenda kufirit prej 2% - 4%, kjo erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve të administruara (energji elektrike, ujë dhe tarifave për shërbimet e kujdesit shëndetësor), rritja e çmimeve të mallrave në tregun botëror, dhe zhvlerësimi i monedhës vendase (megjithatë me ritëm më të ngadalte se në fund të vitit 2009). Nga ana tjetër, presionet e kërkesës së brendshme kanë qenë të dobëta gjatë 2010, si rezultat i vlerave negative të output gap dhe pritjeve fikse për inflacionin. Këto zhvillime janë pasqyruar edhe në vlerat bazë dhe të mallrave jo-të tregtueshëm të inflacionit, të cilat janë afër normave të tyre historike të rritjes. Norma mesatare e inflacionit ishte 3.5% në vitin 2010, ajo u ngadalehua në 3.1% gjatë tremujorit të fundit të 2010, ndërsa në fund të vitit (dhjetor 2010), norma e inflacionit ishte 3.4%. Rritjen e ngadalte monetare dhe veçanërisht e kredive për ekonominë mbështetëse besimin tone për ruajtjen e presioneve inflacioniste të parë nga pikepamja monetare.

Në Janar 2011, inflacioni vjetor kapi shifrën prej 3.3%, ndërsa gjatë muajve Shkurt, Mars, Prill dhe Maj tejkaloi kufirin e sipërm të objektivit të BQ duke regjistruar shifrat, respektivisht, 4.5%, 4.3%, 4.1% dhe 4.2%. E gjitha kjo ishte reflektim i rritjes globale të çmimeve të ushqimeve dhe karburanteve, por në njëfarë mënyre kjo ishte dhe reflektim i rritjes së nivelit të akcizave mbi duhanin si edhe prezantimi i normës prej 10% të tatimit mbi vlerën e shtuar mbi produktet farmaceutike.

Zhvillimet monetare në 2010 janë karakterizuar nga zgjerimi me ritme të larta i rritjes së parase se gjere në krahasim me fundin e 2009, i mbështetur nga zhvillimet pozitive në anën e detyrimeve të bilancit të bankës. Në dhjetor paraja e gjere është rritur me 12.5% në terma vjetorë, krahasuar me 6,8% që ishte në fund të vitit 2009. Agregati monetar në leke (M2) u rrit mesatarisht me 4,6% në terma vjetorë për vitin 2010. Paraja jashtë bankave ka qenë në përputhje me parashikimin me një trend në rënie në vitin 2010. Si i tillë, ky tregues ka regjistruar një ulje mesatare vjetorë prej 6,7% gjatë gjithë vitit,

duke rikonfirmuar edhe tendenca e kthimit te depozitave ne sistemin bankar gjate kesaj periudhe.

Rritja kursimeve te familjeve dhe konsolidimi i metejshe me i besimit ne sistemin bankar vendas kane ndihmuar bankat qe te rikuperojne plotesisht terheqjet e depozitave gjate vitit 2010. Te dhenat per vitin 2010, tregojne se niveli i depozitave ne leke eshte rritur me 11% ne terma vjetore, e cila eshte afer rritjes mesatare 2010, kjo eshte mbeshtetur nga tkurrja e vazhdueshme e parase jashte bankave (mesatarisht me -4.4%). Nderkohe rritja 28% vjetore e depozitave ne valute eshte mbeshtetur nga flukset e dergesave te qendrueshme dhe te aktivitetit te biznesit gjate kohes se veres. Pershtatur per inflacion dhe luhatjet e kursit te kembimit, rritja reale e parase se gjere mbetet me e ulet se niveli i saj historik. Struktura e maturimit te depozitave nuk ka shenuar ndonje ndryshim te rendesishem, si edhe kerkesa dhe depozitat me afat kane konfirmuar rritjen me te larte se nje vit me pare. Depozita me afat perbejne 78% te totalit te depozitave, pak me e larte sesa raporti prej 77% qe ishte ne dhjetor 2009.

Zhvillimet ne tregun monetar tregojne se zgjerimi i parave eshte mbeshtetur nga komponente te huaj te kerkeses per para, si dhe asetave valutore neto te sistemit bankar.

Edhe pse likuiditeti bankar eshte permiresuar dukshem ne krahasim me 2009 dhe bankat kane zbutur disi standardet e kredise, megjithate aktiviteti kredidhenes ka mbetur i ngadalte. Raporti i kredise ndaj PBB-se ne fund te vitit 2010 (Dhjetor 2010) ishte rreth 39.5%, pak me i larte se niveli ne fund te 2009. Ne Dhjetor te vitit 2010, norma vjetore e rritjes se portofolit te kredive ishte pothuajse 9,7%. Edhe pse me pak permiresim ne krahasim me 3,5% ne fund te 2009, ajo vazhdon te jete e ulet. Sipas anketes se huave te Bankes, tregon se kerkesa e ulet per kredi nga agjentet ekonomike eshte shkaku kryesor i rritjes se kufizuar te kredise. Kredisa per bizneset ka kontribuar pozitivisht ne rritjen e kredive, kjo ka shenuar nje rritje prej 13,4% ne terma vjetore ne krahasim me 7,5% qe ishte ne fund te 2009. Kreditimi per individet ka treguar disa permiresime ne terma mujore, por ende vazhdoi te mbetet ne terma te uleta deri ne dhjetor 2010, me nje rritje prej 0.7% ne terma vjetore. Sipas shperndarjes sektoriale te kredise, bankat kane financuar kryesisht ne sektorin e sherbimeve, si rezultat i zhvillimeve pozitive ne kete sektor, sidomos ne tregti. Ne 2 muajt e fundit, kontributi i kredise per sektorin e ndertimit ne rritjen e portofolit te biznesit eshte rritur pak.

Ne pergjithesi, rritja e ngadalte e portofolit te kredive mbeshtet deri tani vleresimin qe kerkesa e brendshme gjate 2010 ka qene e ulet dhe presionet inflacioniste duhet te mbahen ne konsiderate nga pikpamja monetare per te ardhmen.


Norma e interesit ne depozita te reja ka qene ne nje trend ne renie si per monedhen vendase ashtu dhe per ate te huaj. Norma e ponderuar e interesit te depozitave te reja ne leke ka rene me 5%. Nderkohe, ne korrik, Banka e Shqiperise uli normen baze te interesit me 0.25 pp duke arritur ne 5%, renie e trete qe nga shkalla prej 6.25% ne fillim te 2009. Interesi i depozitave ne Euro ka rene, i mbeshtetur nga permiresimet e konsiderueshme ne nivelin e likuiditetit ne valute te huaj. Megjithate interesi i depozitave ne Euro edhe pse ne renie, vazhdon te jete i larte.

Nderkohe kostoja e huamarrjes te kredise ne leke, mesatarisht ka qene e ulur ne krahasim me 2009, dhe pothuajse e barabarte me periudhen e para te krizes financiare. Nderkohe kredisa e re ne euro vazhdon te ruaje kosto me te larte, e krahasuar me nivelin e 2009. Besimi ndaj sektorit financiar dhe bankar eshte rikuperuar plotesisht pas *shoku*-t qe shkaktoi kriza globale. Depozitat bankare u rriten me 18.5% ne vitin 2010 krahasuar me nje vit me pare. Kredia ndaj ekonomise, edhe pse me rritme me te moderuara sesa depozitat, pësoi rritje qe kryesisht ishte reflektim i ri-balancimit te portofolit te kredive nga institucionet financiare por gjithashtu edhe reflektim i nje kërkesë me te ulët te sektorit privat si rezultat i minimizimit te levës financiare. Rritja e kredive ne 2010 ishte rreth 9.2%. Pergjithesisht, kjo rritje i atribuohet perqendrimin te kredive ndaj bizneseve dhe kryesisht ndaj investimeve. Kredia ndaj institucioneve private jo-financiare u rrit me 15%, kurse kredia ndaj konsumatoreve ngeli ne te njehat nivele te nje viti me pare duke rregjistruar nje rritje te lehte prej vetem 1.7%. I njehat trend, si per depozitat ashtu edhe per kredine, vazhdoi edhe gjate katër muajve te pare te vitit 2011. Depozitat u rriten me 16.4% gjate periudhes Janar – Prill 2011, krahasuar me te njehat periudhe te vitit 2010, ndersa kredia per ekonominë u rrit me 11.1%, nje rritje kjo qe i atribuohet kryesisht rritjes se kredise ndaj bizneseve me qellime investimi. Pas nje rritjeje te ngadalte gjate vitit 2010, rritja e kredise ndaj konsumatoreve eshte pershpejtuar gjate muajve te pare te vitit 2011, duke u rritur me 3.3% gjate katërmujorit te pare. Raporti i kredive totale ndaj depozitave totale ishte 62% ne muajin Prill 2011 nga 64.9% ne muajin Prill te nje viti me pare.

Rritja e likuiditeteve ne sektorin financiar, ulja e kërkesës per borxh qeveritar ne tregun e

brëndshëm, reduktimi i primit të riskut dhe ulja e normës së interesit nga autoriteti monetar, të gjitha së bashku kanë cuar në uljen e normave të interesit për të gjitha kredite, bonot qeveritare dhe për depozitat gjatë 2010.

Një indikator i cili ende përbën shqetësim në tregun bankar, është treguesi i dinamikës së kredive të këqija. Ky tregues arriti nivelin 13.6% të totalit të kredive në fund të 2010 nga niveli 10% që ishte në fund të vitit 2009, duke reflektuar kështu edhe presionin e krizës në disa sektore të ekonomisë, në vecanti në sektorin e ndërtimit. Kreditë e këqija ngelen një shqetësim në sektorin bankar, edhe pse këto janë shoqeruar me rritjen e provigjoneve të mbajtura nga bankat në nivelin e 7.6% të totalit të kredive, si dhe me mbajtjen në të njëjtin nivel sigurie të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit prej 15.5% edhe pse sistemi bankar ka shënuar rritje të indikatorëve të fitimit.



Ndryshe nga zhvillimet në kursin e këmbimit në vitin 2009, zhvlerësimi i lekut gjatë vitit 2010 ishte i moderuar. Stabiliteti i lekut gjatë kësaj periudhe reflektohet nga qëndrueshmëria në bilancin oferte-kerkese në tregjet monetare, stabilizimin e pritjeve në vlerën e monedhës kombëtare dhe të tkurrjes së bilancit tregtar. Në përputhje me këto zhvillime gjatë 2010 kur nominal efektivi i këmbimit ka ndjekur një prirje të ngadaleuar zhvlerësimit, duke arritur shkallën minimale vjetore të zhvlerësimit prej 2.5% në nëntor 2010; pothuajse niveli me i ulët që nga janari

2009. Në lidhje me ecurinë e lekut kundrejt valutave të huaja, euro dhe dollar amerikan, gjatë vitit 2010, zhvlerësimi mesatar i lekut ishte respektivisht 4.34% dhe 9.49% në terma vjetor, në mënyrë të konsiderueshme nën zhvlerësimin krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009 (euro / lek dhe USD / leke nënçmuar perkatesisht me 7.54% dhe 13.21%). Efektet sezonale gjatë vitit 2010 ishin të moderuar për shkak të sjelljes së agjenteve të tregut të cilët patën ndikimin e tyre në luhatjet e kërkesës – ofertes për valute të huaja.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2011 Leku është zhvlerësuar kundrejt Euros me rreth 2.8% duke arritur pikën maksimale të këmbimit me 142.64 lekë / euro në 7 qershor 2011, nga 138.8 lekë / euro që ishte në 31 dhjetor 2010. Zhvillimet në kursin e këmbimit pasqyrojnë edhe dinamikën në tregjet e monedhave ndërkombëtare, në të njëjtën kohë Leku është vlerësuar me rreth 6.4% kundrejt dollarit amerikan. Duhet theksuar që zhvlerësimi i Lekut kundrejt Euros në këto dy muajt e fundit, është për shkak të rritjes sezonale të kërkesës për Euro nga kompanitë e huaja që kërkojnë të transferojnë fitimet e tyre për në kompanitë mëna.

Zhvillimet e fundit fiskale

Nga të dhënat paraprake të thesarit të Ministrisë së Financave, për vitin 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 324.7 miliardë lekë (shih tabelën 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 2.7 përqind më të ulëta se parashikimi dhe 8.6 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 362.8 miliardë lekë (shih tabelën 1). Në linjë me politiken fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që u finalizua me miratimin e buxhetit të ri në Korrik 2010), shpenzimet gjatë 2010 ishin 4.5 përqind më të ulëta se në vitin 2009, dhe 9 miliardë më të ulëta se planifikimi sipas aktit normativ. Ulja e shpenzimeve gjatë 2010 kundrejt një viti më parë reflektohet me shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me rreth 29.6 përqind në bazë vjetore; shpenzimet korente janë rritur me 6 përqind në bazë vjetore; huadhenia neto është ulur me 5.6 miliardë lekë kundrejt një viti më parë.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 38 miliardë deri në fund të 2010, 79 miliona lekë më pak se planifikimi, dhe me rënie të ndjeshme kundrejt vitit 2009 që u karakterizua nga një politikë fiskale ekspansioniste (80.9 miliardë lekë ishte deficiti fiskal në fund të vitit 2009). Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me

burime te brendshme (kryesisht huamarrje): 411 milione leke jane te ardhurat nga privatizimi te destinuar per financimin e deficitit; 25.9 miliarde leke te ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qene ne nivelin 10 miliarde leke, ne ;linje me planifikimin.

Nje zhvillim i rendesishem per financat publike ne kete fund viti ishte miratimi i Aktit normativ, ne muajin dhjetor. Duke pare ecurine e te ardhurave dhe shpenzimeve ne buxhetin e konsoliduar si dhe duke ruajtur targetin e politikës fiskale ne terma te deficitit fiskal per 2010 ne 38 miliarde leke, akti normativ ri-alokoi disa shpenzime nga pjesa “korente” dhe “huadhenia neto” e buxhetit ne pjesen e shpenzimeve kapitale, ne nivelin e 5 miliarde leke. Keto fonde shtese u alokuan per Ministrine e Puneve Publike dhe Transportit ne programin “Rrjeti i Rrugeve Nacionale”, per vazhdimin e financimit te disa projekteve te nisura, me financim te brendshem.

Treguesit kryesore te buxhetit te konsoliduar per vitin 2010

Miliarde leke	Janar-Dhjetor '09	Janar-Dhjetor '10	Akti normativ 2010
TE ARDHURAT TOTALE	290.0	324.7	333.7
SHPENZIMET TOTALE	379.9	362.7	371.8
Nga te cilat: SHPENZIMET KORRENTE	283.9	300.9	300.1
Nga te cilat: SHPENZIMET KAPITALE	95.9	67.5	71.0
BALANCA FISKALE	-80.9	-38.0	-38.1
BALANCA PRIMARE	-44.6	+3.6	+3.8


Sipas nivelit te qeverisjes, ne buxhetin e konsoliduar, te ardhurat e qeverise qendrore perbejne per kete periudhe 80 perqind te te ardhurave gjithsej; te ardhurat e qeverisjes lokale (nga taksa dhe tarifa) vetem 3 perqind; ndersa te ardhurat e fondeve speciale rreth 17 perqind te te ardhurave gjithsej ne buxhetin e konsoliduar.

Nga kendveshtrimi i klasifikimit ekonomik te te ardhurave, te dhenat tregojne se Shqiperia ka nje sistem tatimor qe takson me shume konsumin kundrejt te ardhurave dhe pasurise, dhe ky tipar ka ardhur duke u theksuar vitet e fundit. Te ardhurat nga tatimet mbi te ardhurat dhe pasurine se bashku perbejne 15 perqind te te ardhurave gjithsej, ndersa te ardhurat qe mblidhen nga taksimi i konsumit (indirekt) perbejne gati gjysmen (47 perqind) e te ardhurave te buxhetit te konsoliduar.


Te ardhurat ne tremujore

EMERTIMI	2009				2010			
Miliarde leke	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
TE ARDHURAT TOTALE	71.8	72.2	76.1	77.2	79.1	78.6	86.4	87.9
Nga tatime dhe dogana	47.8	51.7	56.3	53.1	49.2	54.7	61.7	58.4
Nga pushteti vendor	3.0	3.9	2.6	2.6	2.7	3.6	2.4	3.2
Nga fondet speciale	13.0	12.5	11.9	11.8	15.2	15.4	15.3	14.2
Te ardhura jo tatimore	7.7	3.2	4.4	7.3	11.8	3.2	6.6	9.8

Te ardhurat sipas llojeve ne gjashtemujore 2009-2010 (mln leke)



Rritja e te ardhurave sipas gjashtemujoreve (% mbi baza vjetore)



Gjate 2010 situata e mbledhjes se te ardhurave tatimore (qe jane 90 perqind e totalit) pati permiresim te ndjeshem kundrejt nje viti me pare, duke u ndikuar nga ri gjallerimi I aktivitetit ekonomik ne vend, ndryshime ne disa taksa dhe vazhdimesia ne uljen e informalitetit. Te ardhurat tatimore u rriten me 6.5 perqind kundrejt nje viti me pare; te ardhurat nga tatime dhe dogana me 6.8 perqind; te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor pesuan 2.1 perqind ulje; te ardhurat ne fondet speciale u rriten me 7.7 perqind; te ardhurat jo tatimore me 33 perqind.

Te ardhurat nga taksimi i konsumit (indirekt) arriten ne 152.8 miliarde leke, ndare ne 114 miliarde leke nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe 38.8 miliarde leke nga akcizat.

TVSH mblidhet mbi mallrat e importuar dhe mbi transaksionet brenda vendit. TVSH ne import ndikohet direkt nga vlere (CIF) e mallrave qe importohen. Gjate vitit 2010, vlere e importeve ka pesuar nje rritje rreth 11 perqind kundrejt nje viti me pare, e ndikuar nga rritja e volumit te importeve (rreth 2.9 perqind krahasuar me 2009), rritja e pergjithshme e cmimeve te lendeve te para (commodities) dhe produkteve bujqesore ne tregjet nderkombetare krahasuar me 2009, dhe zhvleresimi i monedhes shqiptare ndaj euros dhe dollarit (perkatesisht me 5 dhe 9 perqind). TVSH e mbledhur ne dogana mbi mallrat e importuar per vitin eshte 84.8 miliarde leke, 9.6 perqind me shume se viti 2009. Gjate 2010 importet jane dominuar nga mallrat e konsumit te perdritshem (ushqime, pije, duhan, lende djegese), tekstile dhe kepuce si dhe materiale ndertimi dhe metale.

TVSH mbi shitjet brenda vendit ka pesuar renie te ndjeshme kundrejt nje viti me pare, prej rreth 10 perqind. Sektorët e ekonomise me renie me te ndjeshme te pagesave te TVSH-se krahasuar me 2009

kane qene ndertimi dhe telekomunikacioni, per arsye te qarta : sektori i ndertimit ka me pak vlere te shtuar gjate 2010, edhe si pasoje e reduktimit te investimeve publike ; ne sektorin e telekomunikacioneve ka patur nje nivel te larte investimesh qe kane akumuluar TVSH te kreditueshme, si dhe ulje te tarifave te telefonise celulare. Gjate 2010 eshte rritur ndjeshem dhe niveli i TVSH-se se rimbursuar, sepse eksportet kane qene pjese dominuese e aktivitetit ekonomik ne vend dhe sic dihet Shqiperia takson eksportet me norme TVSH-je zero.

Persa i takon strukturese se tatimit, qe nga 1 Janari 2010 pragu per regjistrimin me TVSH eshte 5 milione leke (rreth 38 mije Euro) qarkullim vjetor nga 8 milione. Qellimi i ketij ndryshimi eshte rritja e formalizimit te transaksioneve mes biznesit te vogel dhe te madh. Niveli i ri konsiderohet me “normal” per kete faze te zhvillimit ekonomik dhe eshte me afer eksperiencave te vendeve te tjera. Per profesionet e lira, kufiri i regjistrimit per TVSH u vendos ne 2 million leke qarkullim vjetor.

Zhvillim tjetër i rendesishem gjate vitit 2010 ishte perjashtimi nga TVSH i sherbimeve te arsimit privat dhe publik.

Te ardhurat nga akciza gjate ketij viti ishin 38.8 miliarde leke, me rritje vjetore 15.8 perqind. Te ardhurat nga akciza jane ndikuar direkt nga ecuria e konsumit per keta artikuj dhe nga ndryshimet e politikës per kete takse. Ndryshimet ligjiore qe kane perfshire kete takse gjate 2009-2010 kane qene : ne shtator te vitit 2009 u rrit akciza e kafes (e papjekur nga 50 lek ne 70 dhe e pjekur nga 100 ne 140 leke per kg) dhe akciza e cigares (nga 40 lek per pakete ne 50 lek); ndersa ne qershor te vitit 2010 ndryshimet ishin akoma me te ndjeshme: u ul akciza mbi kafen e papjekur (nga 70 lek ne 30 lek per kg), u hoqen nga lista e mallrave me akcize lengjet e frutave dhe pijet freskuese, ne grupin e nenprodukteve te naftes shtohet artikulli “nafte virgin” me nivel akcize 50 lek per liter, shtohen ne listen e mallrave me akcize: fishekzjarret, gommat, pilat dhe baterite primare, ambalazhet; ndryshon taksimi i llampave inkandeshente nga ad valorem ne shume fikse.

Duke iu referuar te dhenave per 11 mujorin (te detajuara), te ardhurat nga akciza mbi cigaren jane rritur per 2010 me 14.3 perqind; futja ne liste e mallrave te reja me akcize ka dhene nje efekt te perafert mbi te ardhurat prej rreth 1 miliard; kane pesuar renie te ardhurat nga taksimi i pijeve alkoolike me 2.9 perqind; ndersa te ardhurat nga taksimi i karburanteve eshte rritur me rreth 11 perqind. Te ardhurat nga karburantet e prodhuara ne vend kane pesuar nje ulje prej rreth 50 perqind si pasoje e ngadalesimit te aktivitetit te ARMO gjate ketij viti

Taksimi direkt

Taksimi individual i te ardhurave perfshihet ne tatimin mbi te ardhurat personale, me te ardhura vjetore per 2010 ne nivelin 27.1 miliarde leke, ose 0.9 perqind me shume se nje vit me pare. Per te kuptuar me mire ecurine e ketij taksimi, zberthejme te dhenat sipas burimeve te ndryshme te te ardhurave individuale. Sipas te dhenave te detajuara per 11-mujorin, te ardhurat nga tatimi mbi pagen e te punesuarve te sektorit publik kane nje rritje vjetore prej 7 perqind (11-mujor 2010 kundrejt 11-mujor 2009); te ardhurat nga tatimi mbi pagen ne sektorin jo-publik kane rritje vjetore prej 12.2 perqind, cka tregon rritje te indikatorit “eage bill”, qe ndikohet nga niveli i punesimit dhe niveli i pagave, dmth ecuri ne rritje te aktivitetit ekonomik ne vend; te ardhurat nga interesat per periudhen jane pak a shume ne te njejtin nivel me nje vit me pare.

Te ardhurat nga taksimi individual sipas burimit te te ardhurave

Te ardhura, miliarde leke	11 mujor 2009	11 mujor 2010	Ndryshimi %
Paga sektori publik	7.1	7.6	+7.0
Paga sektori jo publik	6.5	7.3	+12.2
Interesa	2.82	2.85	+0.9
Dividende	0.8	1.3	+56.7
Shitje pasuri e paluajtshme	2.0	2.2	+10.1
Te tjera	4.9	2.9	-40.2

Tatimi mbi te ardhurat nga biznesi

Te ardhurat nga taksimi i aktivitetit te biznesit per vitin 2010 arriten ne 19.9 miliarde, me nje

rritje te lehte vjetore prej 1.5 perqind. Ky taksim perfshin tatimin mbi fitimin (te ardhurat e kompanive) e subjekteve me xhiro vjetore mbi 8 milione leke dhe taksimin e bizneseve te vogla (me xhiro vjetore nen 8 milione leke). E para mblidhet dhe administrohet ne nivel qeverie qendrore, e dyta nga pushteti vendor.

Te ardhurat nga tatimi mbi te ardhurat e kompanive gjate 2010 jane 2.7 perqind me te larta se nje vit me pare. Ecuria mujore e mbledhjes se tatim fitimit ka qene shume e "crregullt" gjate ketij viti. Vecanerisht gjate gjashtemujorit te pare te 2010 mbledhja e te ardhurave te tatim fitimit ka qene ndjeshem nen nivelin e pritshem per arsye te rishikimit ne ulje te kesteve te parapagimit nga subjektet tatimpagues, si dhe te rritjes se teprices kreditore te tatim fitimit krahasuar me nje vit me pare. Mbledhja e tatimit eshte permiresuar ndjeshem gjate muajit gusht, shtator, nentor dhe dhjetor. Numri i subjekteve aktive, qe i nenshtrohen tatim fitimit, sipas te dhenave me te perditesuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, per 2010 eshte rritur me 14 perqind kundrejt mesatares se vitit 2009.

Te ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogel per vitin 2010 jane 6.8 perqind me te uleta se nje vit me pare, edhe pse numri i subjekteve aktive qe i nenshtrohen kesaj takse rezulton te jete rreth 9 perqind me i larte se mesatarja e vitit 2009. Administrimi dhe mbledhja e takses vazhdojne te mbeten problematike. Eshte duke perfunduar pajisja e te gjitha tatimpaguesve me kasa regjistruese dhe kjo pritet te jape efekt vecanerisht ne formalizimin e transaksioneve te bizneseve te vogla dhe ne deklarimin real te xhiros se tyre, mbi te cilen llogaritet taksa vendore e biznesit te vogel.

Taksimi i pasurise

Perfshin tatimin mbi ndertesat, mbi token bujqesore dhe taksen e kalimit te pasurise se paluajtshme. Eshte prej kohesh nje pjese problematike e sistemit tatimor, persa i takon te ardhurave te mbledhura kundrejt te ardhurave potenciale qe mund te mblidhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i takses mbi pasurine rezulton te jete pergjithesisht efektiv persa i perket bizneseve dhe institucioneve / organizatave dhe ndjek te njejten tendence ne arritjen e nivelit te parashikuar te te ardhurave me taksat dhe tarifat e tjera te aplikueshme nga njesite vendore (tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndricimit). Nderkohe, eksperiencia nuk eshte e njejte per kategorine "Familjare" te taksapaguesve. Ketu tendenca ne grumbullimin e kesaj takse eshte e ulet, dhe njesite e qeverisjes vendore kane mjaft probleme ne administrim dhe ne detyrimin per pagimin e takses. Per nivelin ende te larte te informalitetit, ka mjaft veshtiresi ne vleresimin e bazes se taksueshme, per arsye te mangesive ne deklarimin real te pasurive. Per vitin 2010 taksat mbi pasurine arrijne ne 1.9 miliarde leke, ose 25.6 perqind me te larta se nje vit me pare. Ne totalin e te ardhurave tatimore ne Shqiperi ky grup taksash ze vetem 0.71 perqind, kundrejt 6 perqind qe eshte mesatarja e vendeve te OSBE.

Taksa te tjera

Te ardhurat nga taksat nacionale per vitin 2010, jane 18.3 miliarde leke me nje rritje prej 36.5 perqind. Kontributin kryesor ne kete rritje e kane patur taksat e mbledhura mbi kazinote dhe lojrat e fatit (rritje vjetore 65 perqind) dhe renta minerare (rritje vjetore 100 perqind). Taksa te rendesishme ne kete grup jane dhe taksa mbi transaksionin e makinave te perdorura, te ardhurat nga te cilat jane ne renie me 7.2 perqind kundrejt vitit 2009 dhe taksa e qarkullimit rrugor.

Gjate vitit 2010 taksa e importimit te automjeteve te perdorura u shfuqizua dhe u zevendesua me taksen mbi transaksionin e automjeteve te perdorura, duke shtrire taksimin edhe mbi shit-blerjet e tyre brenda vendit, duke mbajtur te pandryshuar objektivin mjedisor te kesaj politike.

Ndryshime pati edhe ne strukturen dhe nivelet e rentes minerare, takse qe mblidhet mbi nxjerrjen, shfrytezimin dhe eksportin e burimeve natyrore, te cilat pesuan rritje.

Te ardhurat e mbledhura nga taksat vendore per vitin 2010 arriten ne 11.9 miliarde leke ose 2.1 perqind me pak se nje vit me pare. Taksat e tjera vendore (pa taksen e biznesit te vogel dhe taksat mbi pasurine per te cilat folem me lart) kane mbledhur rreth 7.7 miliarde leke nga 10.4 te parashikuara, dhe 5.9 perqind me pak se vitin e kaluar.

Te ardhurat ne fondet speciale

Te ardhurat ne fondet speciale per vitin 2010 arriten ne 53.7 miliarde leke, me nje rritje prej 7.7 perqind kundrejt te njejtës periudhe te nje viti me pare. Ky grup te ardhurash perben rreth 20 perqind te te ardhurave tatimore gjithsej per vitin 2010. Nga totali i fondeve speciale, 51.5 miliarde leke jane kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, ose 3.3 perqind me shume se nje vit me pare. Persa i takon bazes se taksueshme, nga te dhenat paraprake te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, per periudhen 11-mujore te 2010 rezulton se: ne total ka nje rritje te numrit mesatar te te punesuarve per efekt te derdhjes se kontributeve (sektor shtetror dhe sektori privat) prej 3.5 perqind, ose rreth 13 mije kontribues, kundrejt mesatares vjetore te 2009. Per sektorin privat rritja e numrit te te punesuarve

(mesatare 11-mujor 2010 kundrejt mesatares 12 - muhor 2009) eshte 5.8 perqind ose afersisht 12 mije kontribues me shume. Megjithate, brenda kesaj shifre, subjektet me TVSH kane nje rritje te kontribuesve prej 7 perqind (ose 11 mije kontribues) ndersa subjektet e biznesit te vogel nje rritje me modeste prej 2.9 perqind. Numri mesatar i kontribuesve ne sektorin publik (buxhetore dhe ndermarrje shtetore) rezulton i njejte me mesataren e vitit 2009.

Bazuar ne te dhënat paraprake te ardhurat totale janë rritur me rreth 0.8% gjatë periudhës Janar - Maj 2011 në terma vjetorë, ndërsa të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë rreth 5% më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2010. Mbledhjen e të ardhurave totale për periudhën Janar - Maj 2011 ka qenë rreth 7.3 miliardë lekë ose 5.4% më pak se objektivi për këtë periudhë, ku rreth 2 miliardë lekë të këtij mosrealizimi vijnë nga të ardhura të cilat nuk çënojnë qëndrueshmërinë e buxhetit (aftësia për të përmbushur objektivin e deficitit fiskal) të tilla si të ardhurat nga taksat lokale dhe grantet.

Objektivi për deficitin fiskal për vitin 2011 është 3.5% të PBB-së (ose 46.8 miliardë lekë) dhe 3% për tre vitet e ardhshme 2012 - 2014. Qeveria është në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2011. Rregullimet e nevojshme do të realizohen në mënyrë që të arrihet objektivi i politikës fiskale për vitin 2011, duke synuar një deficit të përgjithshëm prej 3.5% të PBB-së. Buxheti i rishikuar është planifikuar që të finalizohet dhe të miratohet nga Kuvendi jo më vonë se fundi i korrikut 2011.

Kuadri makroekonomik afat-mesem

